



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.16/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtorin profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 27.09.2024 të parashtruar nga ankuesi I. R., avokat nga Prishtina, për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B. A. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë, më datë 14.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e parashtruar nga I. R., avokat nga Prishtina, e datës 27.09.2024, për inicimin e procedurës disiplinore të paraqitur ndaj gjyqtarit B. A. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë, konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Më datë 27.09.2024, avokati I. R. nga Prishtina, ka parashtruar ankesë ndaj gjyqtarit B. A., duke pretenduar se i njëjti me veprime të kundërligjshme ka shkaktuar dëm të pariparueshëm për palët që i përfaqëson në kontest në lëndët civile C.nr.55/2022, C.nr.134/2022 dhe C.nr.179/2022. Lidhur me dy lëndët e para, ka theksuar se i njëjti është përfaqësues me prokurë i paditësve, e të cilat lëndë gjyqtari në fjalë i ka kthyer në plotësim duke i kërkuar avokatit që padinë C.nr.55/2022 ta precizojë, ndërsa padinë C.nr.134/2022 ta plotësojë me adresën e saktë të të paditurit. Përkundër se avokati ka plotësuar paditë sipas aktvendimeve procedurale, të njëjtat përsëri janë hedhur poshtë nga gjyqtari i lëndës – B. A., ndërsa sa i përket lëndës C.nr.179/2022 në të cilën është përfaqësues me prokurë i të paditurit, gjyqtari nuk ka miratuar propozimin për shtyrje të seancës, ashtu që në seancë ka prezantuar personalisht i padituri, i cili po ashtu ka kërkuar shtyrjen dhe pastaj është larguar nga gjykimi pa nënshkruar procesin, si dhe nuk ka njoftuar për seancën e rradhës të njëjtin. Nga këto veprime ka konsideruar se gjyqtari ka sjellje të pahijshme, prandaj ka kërkuar inicimin e procedurës disiplinore ndaj tij. Me këtë ankesë ka kërkuar nga kryetari i gjykatës që të përjashtohet gjyqtari në fjalë nga lëndët ku përfaqëson i njëjti.

Kryetari i gjykatës i ka kërkuar gjyqtarit të çështjes të deklarohet lidhur me pretendimet e ankuesit.

Gjyqtari B. A. në deklaratën e tij lidhur me pretendimet e ankuesit ka theksuar se më datë 22.07.2024 ka marrë aktvendim për hedhje të padisë në lëndën C.nr.55/2022, për shkak se përfaqësuesi i paditësit nuk ka plotësuar padinë sipas aktvendimit për plotësim, me të cilën është kërkuar të specifikojë

kërkesat dhe llojet e dëmeve që i kërkon, ndërsa plotësimin e tij nuk e ka gjetur të plotë, prandaj edhe ka marrë aktvendimin për hedhje të padisë. Lënda në fjalë gjendet për shqyrtim në procedurën ankimore në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Edhe sa i përket lëndës C.nr.134/2022 ka konsideruar se plotësimi i padisë nuk është i plotë, meqë paditësi pa dhënë asnjë provë ka shkruar se i padituri ndodhet në adresë të panjohur. Edhe për këtë aktvendim, paditësi ka mundësinë e paraqitjes së ankesës. Në marrjen e këtyre vendimeve ka theksuar është bazuar në kapitullin VII, nenet 99-102 të LPK-së, si dhe udhëzimet nga trajnimet dhe seminarët e ndjekur në 5 vitet e fundit. Sa i përket lëndës C.nr.179/2022 ka theksuar se avokati I. R. ka kërkuar shtyrjen e seancës për shkak se ka qenë i ngarkuar me një tjetër lëndë, por kjo kërkesë i është refuzuar meqë vlerëson se nuk është arsye e justifikuar shtyrja e seancës për shkak të datave të seancave të caktuara nga avokati. I përfaqësuari i tij ka lëshuar seancën dhe kjo është konstatuar në procesverbal, ndërsa për datë 23.10.2024 është ftuar për seancë. Lidhur me shprehjen e fjalorit të avokatit ka konsideruar se duhet të informohet Oda e Avokatëve të Kosovës.

Kryetari i gjykatës, pas pranimit të ankesës të paraqitur nga pala ankuese, deklaratës së paraqitur nga gjyqtari B. A. dhe analizimit të pretendimeve të ankuesit, ka gjetur se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë më ndonjë shkelje të mundshme disiplinore, prandaj ankesa e të njëjtit është e pabazuar dhe pretendimet në të nuk e justifikojnë iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit në fjalë.

Deri te një përfundim i tillë kryetari i gjykatës erdhi pasi konstatoi se pretendimet e avokatit konsistojnë në pretendime ankimore, përkatësisht të njëjtat i drejtohen mënyrës së vendosjes së gjyqtarit në fjalë, lidhur me aktvendimet për hedhje të padisë dhe aktvendimit për refuzim të kërkesës për shtyrje të seancës gjyqësore, të cilat nuk mund të konsiderohen si veprime që janë në kundërshtim me etikën e gjyqtarit dhe si të tilla nuk mund të cilësohen si shkelje disiplinore nga ana e të njëjtit, ngase gjyqtari mandatin e tij gjyqësor e ushtron në mënyrë të pavarur dhe profesionale, duke i vlerësuar në mënyrë individuale të gjitha faktet dhe provat që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm dhe në mënyrë meritore, ashtu që pretendimet lidhur me mënyrën e vendosjes i përkasin mjeteve juridike për atakim të atij vendimi, e jo iniciimit të procedurës disiplinore. Ankuesi ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike ligjore për të kundërshtuar një vendim që e konsideron jo të drejtë dhe të ligjshëm, e në rastin konkret pretendimet e të njëjtit janë të orientuara në këtë drejtim dhe nuk mund të prodhojnë efekt në procedurë disiplinore, apo në ndonjë shkelje të paraparë në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë dhe Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e I. R., avokat nga Prishtina, e datës 27.09.2024, është e pabazuar dhe për të njëjtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryetari i Gjykatës,
Venhar Salihu**

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Gjyqtarit B. A.,
2. Parashtruesit të ankesës,
3. KGJK-së
4. Dosjës së lëndës.